Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**30.10.2023**	**10.11.2023**	**2023/0781**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.10.2023, OE "Gezime S. Gashi B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0781, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "AOME "SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me dru per ngrohje" me nr. të prokurimit: "632-23-8985-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratëskontrata publike kornizë-furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 53,300.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK KOMUNA E GJAKOVËS e ka respektuar Ligjin për Prokurimi Publik dhe Rregulloren për Prokurim Publik, mirëpo Grupi i OE "RRON 2019 & N.P.T "METI COMERC" për arsye teknike të e-prokurimit nuk ka mundur ta hap kërkesën për sqarime që Zyrtari i Prokurimit e ka ngritur në sistem, prandaj kërkojm mirëkuptim që kërkesa jonë për rishqyrtim të na e jep edhe një afat shtesë për t'i dhënë sqarimet tona në kërkesat e KOMUNËS SË GJAKOVES.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja muna të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Grupi i OE "RRON 2019 & N.P.T "METI COMERC" për shkak të problemeve teknike në e-prokurim dhe për arsye se kontabilisti kishte të bëntë me zhvillimet në veri, nuk e ka kuptuar kërkesën për sqarime të AK KOMUNA E GJAKOVËS.

Rrjedhimisht, kontabilisti ishte i afert me familjen e policit të vërar Afrim Bunjaku dhe për shkak të problemeve teknike nuk ka mundur ta hap kërkesën për sqarime.

Ne Grupi i OE "RRON 2019 & N.P.T "METI COMERC" jemi më të lirët me cmim dhe jemi të përgjegjshëm, prandaj me mirëkuptim i kërkojm Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që për arsye të rrethanave të paraqitura më lartë, të na ipet një afat shtesë qoftë edhe për një ditë për t'i dhën sqarimet tona lidhur me aktivitetin e prokurimit

"Furnizim me dru per ngrohje".

Pra ne do të përgjigjemi menjherë në kërkesën për sqarime sepse jemi Grup i OE që jemi të përgjegjshem dhe do ta realizojmë tenderin me cmim më të ulët që do të jetë edhe në dobi dhe me shpenzime më të ulta për Komunen e Gjakovës.

. Dëmet materiale

'ërshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme ıateriale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Grupi i OE "RRON 2019 & N.P.T "METI COMERC" është taksapagues i rregullt i taksave dhe tatimeve të vendosura me ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të Republikës së Kosovës, që janë pjesë e të hyrave shtetrore dhe KOMUNA E GJAKOVËS ka vepruar sipas ligjit, mirëpo dëmtimi është pasojë e problemeve teknike me e-prokurim, për shkak të të cilave Grupi i OE "RRON 2019 & N.P.T "METI COMERC" nuk i është përgjigjur në kërkkesë AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

GJAKOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

B58 - NJOFTIM MBI RI-VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Furnizim me dru për ngrohje

Nr. i prokurimit	**632-23-8985-1-2-1**
Nr i brendshëm	**632-23-135-121**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	"AOME" SH.P.K., Gjeravica, 10000, KOLOVICE	48.191,40€
2.	"WOOD COMPANY" SH.P.K., Lagjia Vitija, Marec, Prishtine, 10000, Prishtine	55.596,00€
3.	Milaim Bejta B.I., z.industriale prishtinë, 10000, prishtinë	64.780,00€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I.; N.P.T. Meti Comerc, Jakup Ferri, nr.5, 10000, Prishtine	47.888,00€
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik Avni Murtezi B.I.; N.P. Urani Com, Jakup Ferri, PRISHTINË	57.318,00€
6.	N.T.P."GRESA - COMMERCE", Pirane, PIRANE	51.496,00€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Komuna e Gjakove **shpërblen** me kontratë: **"AOME" SH.P.K., Gjeravica, 10000, KOLOVICE,** në vlerë totale të ofertës **48.191,40€.**

Data: 27.09.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP: Faton Gutaj

REPUBLIKA E KOSOVËS Komuna e Gjakovës Kryetari i Komunës

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).
[2] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde te njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me te dhena.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Gëzime S. Gashi B.I.**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratëskontrata publike kornizë-furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës 53,300.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se për shkak të problemeve teknike në e-prokurim dhe për arsye se kontabilisti kishte të bënte me zhvillime në veri nuk ka kuptuar kërkesën për sqarime të AK –Komuna e Gjakovës. Tutje OE ankues shton se kontabilistit ishte i afërt me familjen e policit të vrarë Afrim Bunjaku dhe për shkak të problemeve teknike nuk ka mundur ta hap kërkesën për sqarime. Ankuesi pretendon se është më i lirë me çmim dhe janë të përgjegjshëm, andaj kërkojnë nga zyrtari përgjegjëse i prokurimit për arsye të rrethanave të paraqitura më lartë të i'u jepet një afat shtesë qoftë edhe për një ditë për ti dhënë sqarimet lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se AK Komuna e Gjakovës, me datën **21.09.2023** përmes letrës standarde për sqarimet e tenderit ka kërkuar nga OE ankues sqarime për kërkesat e Përshtatshmërinë profesionale, Kapacitetin ekonomik financiar, Kapacitetin teknik dhe profesionale, po ashtu në këtë kërkesë të AK-së ceket se përgjigjet duhet të pranohen përmes platformës së e-prokurimit deri me datën **25.09.2023.**

Meqenëse OE nuk kishte kthyer përgjigje, AK ka vazhduar me operatorin ekonomik të dytë me radhë me çmim më të lirë, ku me datë 27.09.2023 përmes njoftimit B58 ka njoftuar me rezultatet për këtë aktivitet të prokurimit duke e rekomanduar për kontratë OE "AOME" Sh.p.k.

OE ankues i pakënaqur me këtë njoftim ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 03.10.2023. Ndërsa, AK me datë 06.10.2023 nëpërmjet vendimit e refuzon kërkesën për rishqyrtim dhe vërteton njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se autoritetit kontraktues me të drejtë ka vepruar në këtë rast

për faktin se kishte kërkuar sqarime nga OE ankues dhe i ka dhënë kohë të mjaftueshme operatorit ekonomik për të kthyer përgjigje me sqarimet e kërkuara por OE ankues nuk kishte kthyer përgjigje sipas kërkesës së AK-së. Sa i përket arsyetimit të OE ankues se "**për shkak të problemeve teknike në e-prokurim** dhe për **arsye se kontabilisti kishte të bënte me zhvillime në veri nuk ka kuptuar kërkesën për sqarime të AK –Komuna e Gjakovës", Ekspertja shqyrtuese** sqaron se për arsyetimin e parë, OE ankues nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo ndonjë kërkesë drejtuar Krpp-së që ta vërteton/verifikon se sistemi ka pas probleme, ndërsa sa i përket arsyetimit të dytë, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se pa marr parasysh ngjarjet e renda në veri të vendit, nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore që përjashton mos kthimin e përgjigjes në kërkesën e AK-së. Andaj, operatorët ekonomik të cilët shprehin interes për një aktivitet të prokurimit, duhet të jenë vigjilent dhe përgjegjës për kërkesat dhe afatet ligjore të cilat janë të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.

<u>Provë: Kërkesa për sqarime te tenderit nga AK -Komuna e Gjakovës</u>

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

Datë: 21.09.2023

KOMUNA E GJAKOVËS, Rr "Nënë Tereza" 50000 GJAKOVË

Për: **Grup i Operatorëve Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I.; N.P.T. Meti Comerc, Jakup Ferri, nr.5, 10000, Prishtine**

Nr. i prokurimit:	**632-23-8985-1-2-1**
Nr i brendshëm	**632-23-135-121**

Titulli: Furnizim me dru për ngrohje

E nderuara Znj. Gëzime Murtezi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës për prerje dhe transport te druve për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 106.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 79.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme.
- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë 3 kamiona me peshë ngarkuese minimum 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit)
- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 6 (gjashtë) punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e furnizimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës - (kopje)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklaratë Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për 3 (tri) vitet e fundit (kopje).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve.

- Lista e mjetet-paisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose kontrata mbi qiramarrjen, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturë.(Lista duhet vërtetuar nga Operatori Ekonomik).
- Lista e punëtoreve te jetë e nënshkruar dhe e vulosur si dhe ti bashkangjiten edhe kontratat e punës.

SQARIM:

Kërkojmë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së për:

- Ju si Grup i Operatorëve Ekonomik keni prezentuar Licencën nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës, vetëm nga Operatori Ekonomik Meti Comerc, ju duhet ta prezentoni licencën në fjalë edhe për Operatori Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I., qarkullimin financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 106.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë nuk e keni prezentuar, listen e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit e keni prezentuar por nuk keni prezentuar dëshmi kontratat dhe referencat, listen e mjetet-paisjeve teknike e keni prezentuar por nuk keni prezentuar dëshmi kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose kontrata mbi qiramarrjen, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturë dhe listen e punëtoreve e keni prezentuar por nuk keni prezentuar dëshmi kontratat e punës.

Andaj kërkojmë nga ju te na ofroni dëshmi Licencën nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës edhe për Operatori Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I, qarkullimin financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 106.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, kontrata dhe referenca, kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose kontrata mbi qiramarrjen dhe kontratat e punës me stafin.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen përmes platformës se prokurimit elektronik deri me dt.**25.09.2023.**

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,

Faton Gutaj

Prandaj në mbështetje te asaj qe u përshkrua si më lartë sqarimeve dhe provave të bashkangjitura ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa propozoj qe AK të vazhdoj tutje .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E GJAKOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Gëzime S. Gashi B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli